



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1022 prot.

Tiranë, më 29.05. 2026

V E N D I M

Nr.144, datë 29.05. 2026

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është regjistruar ankesa nr.270 Regj., datë 21.11.2025, paraqitur nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar, përfaqësuar nga znj. A.L, Presidente, kundër Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë, për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ndër të tjera pala ankuese shpjegon se:

“Për të dytën herë radhazi ndihem e diskriminuar si organizatë në Shkollën 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”.

Rasti i parë ka ndodhur në 26.06.2025, ku përveç se nuk mundëm të realizojmë takimin të cilin e ndërpreu drejtori, pas vetëm 5 minutash, u anashkalua edhe një komision etike ndaj një mësueseje që shkeli rëndë etikën institucionale në momentet e para të takimit. Pesë minuta pasi filloi takimi hyn drejtori i shkollës dhe ju thotë mësuesve, ky takim nuk është i ligjshëm, duhet të ngriheni. E pyesim drejtorin dhe ai tregon që mori një telefonatë nga ZVA Tiranë për të ndërprerë takimin.

Rasti i dytë ka ndodhur në muajin tetor, në datë 27.10.2025, ku rikërkoj takim në email për të organizuar mësuesit, në vendin e punës si organizatë SBASH, në mjediset e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës” Tiranë. Drejtori i Shkollës më kthen përgjigje po me email se nuk mund të

¹ Në vijim do t’i referohemi me Komisioneri.

futem pa lejen e ZVA Tiranë dhe MAS. Ndërkohë organizatat e tjera sindikale FSASH dhe SPASH hyjnë lirisht. I shkruaj përsëri në 15 nëntor dhe nuk marr përgjigje.

Në një takim në ZVA Tiranë ku i tregoj drejtoreshës së ZVA Tiranë dhe juristes se po më ndodh të pengohem për të kryer funksionet e mia tek kjo shkollë, juristja përgjigjet që ne nuk mund të mësojmë drejtorët, ata janë vetë të përgjegjshëm, ndërsa drejtoresha hesht.”

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri, të hetohet situata e krijuar dhe të merren masa administrative ndaj drejtuesit të Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”. Të hetohen interpretimet që dërgohen nga ZVA Tiranë në shkollat e varësisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, ndërsa garanton në mënyrë të shprehur mbrojtje nga diskriminimi për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,* ndërsa në nenin 12, *“Ndalimi i diskriminimit”,* pika 1, gema “ç”, të po këtij ligji, parashikohet: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfutuar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.”* Duke përdorur termin *“ndër të tjera”,* situatat e listuara nga neni 12, pika 1, janë orientuese dhe mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit, sipas LMD ofrohet në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me të drejtën për punësim dhe profesion dhe jo vetëm për përcaktimet e bëra nga neni 12.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi

personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet : *“1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri””*

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet : *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”*

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.*

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. 8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”*

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose*”

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve

përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar (SBASH), ka fituar personalitet juridik me vendimin nr.3, datë 15.02.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe qëllimi i përcaktuar në aktet e saj të themelimit është, të përfaqësojë të gjithë punëmarrësit në arsimin parashkollor, arsimin parauniversitar, arsimin e lartë, arsimin profesional dhe punonjësit e tjerë në këto sektorë, të punësuar në Republikën e Shqipërisë, për mbrojtjen e interesave sociale dhe ekonomike të tyre në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.

Bazuar në ankesën e paraqitur, pala ankuuese pretendon se, është cenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, si person juridik, pasi Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, Tiranë, e ka diskriminuar duke e trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme në gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave sindikale, krahasimisht me sindikatat e tjera të cilat janë nënshkruese të Kontratës Kolektive me MAS.

Bazuar në sa më sipër, pala ankuuese, SBASH, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe legjitimohet për të paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi kundër Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes” Tiranë.

Ankesa është paraqitur brenda afateve kohore të parashikuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të LMD-së, pasi diskriminimi i pretenduar ka ndodhur, rasti i parë në datë 26.06.2025, rasti i dytë 27.10.2025, kur Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shqiptar, përfaqësuar nga znj. A.L , i është drejtuar Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes” për zhvillimin e një takimi në ambientet e saj, por shkolla nuk ka lejuar dhe ka refuzuar zhvillimin e takimit.

Ankesa përmban elementët e kërkuar nga LMD për pranimin e saj dhe shqyrtimin në themel të pretendimeve të parashtuara nga pala ankuuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1630/1 prot., datë 04.12.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Shkolla 9-vjeçare Kongresi i Lushnjës, Tiranë, Ministria e Arsimit (MA) dhe nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë (ZVAP Tiranë).

2. Me shkresën nr.12651/1 prot., datë 10.12.2025, ka kthyer përgjigje ZVAP Tiranë, duke parashtruar ndër të tjera:

Në lidhje me përgjigjen e kthyer nga Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë, mbi ndërprerjen e takimit apo moslejimin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shqiptar, që të zhvillojë takime në ambientet e kësaj shkolle, sqarojmë se është kompetencë e çdo drejtori për menaxhimin dhe funksionimin e institucionit arsimor që ai drejton, për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

ZVAP Tiranë nuk ka asnjë praktikë të mbajtur në lidhje me këtë rast, si dhe në veprimtarinë e saj të përditshme udhëhiqet nga parimi i zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe respektimin e të gjitha të drejtave të njohura dhe të fituara nga çdo sindikatë e arsimit që operon dhe funksionon në fushën e arsimit parauniversitar.

3. Me shkresën nr.169 prot., datë 11.12.2025, ka kthyer përgjigje Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë, duke parashtruar:

Informohemi se ankuesja ka paraqitur disa raste të cilat sipas saj përbëjnë trajtim të pabarabartë me subjekte të tjera të cilat në objektin e veprimtarisë së tyre kanë organizimin e sindikatave të personelit arsimor të “mësuesve”.

Rasi i parë, më datën 26.06.2025, ankuesja pretendon se nuk u lejua të realizonte një takim me stafin pedagogjik të shkollës, sepse nuk ishte e pajisur me një autorizim nga ZVAP Tiranë apo nga MA. Ankuesja shton se, pavarësisht kërkesës së përsëritur nga anëtarët e saj, drejtori refuzoi të lejonte zhvillimin e takimit.

Rasti i dytë, më datë 27.10.2025, ankuesja deklaroi se ka kërkuar nëpërmjet *e-mail*-it të organizojë një mbledhje me mësuesit në ambientet e shkollës. Drejtori i është përgjigjur po me *e-mail*, duke sqaruar se hyrja nuk mund të bëhet pa lejen e ZVA Tiranë dhe MA. Ankuesja shton se, sipas saj, organizatat e tjera sindikale si FSASH dhe SPASH hyjnë lirshëm në shkollë, ndërsa SBASH është penguar.

Komunikimi i mëvonshëm më datë 15.11.2025, ankuesja deklaroi se ka dërguar një *e-mail* të dytë, por nuk ka marrë përgjigje.

Takimi në ZVAP Tiranë, ankuesja pretendon se ka ngritur shqetësimin pranë Drejtoreshës së ZVAP Tiranë, ku sipas saj juristja ka deklaruar “ne nuk mund të mësojmë drejtorët, ata janë vetë të përgjegjshëm”, ndërsa drejtoresha ka heshtur.

Në lidhje me pretendimet e ankueses më duhet t’iu informoj sa më poshtë:

Më datë 26.06.2025, znj.A.L , e vetëdeklaruar si Kryetare e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shqiptar (SBASH), është paraqitur në ambientet e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë, pa njoftim paraprak dhe nuk kishte asnjë dokumentacion zyrtar që vërtetonte legjitimitetin e saj si

përfaqësuese e një organizate sindikale. Ajo ka nisur të zhvillojë një mbledhje me mësuesit pa dijeninë e drejtorit dhe pa respektuar procedurat ligjore për përdorimin e ambienteve publike arsimore.

Drejtori i Shkollës, duke vlerësuar urgjencën e situatës dhe faktin se mbledhja kishte nisur pa leje, është konsultuar menjëherë me ZVAP Tiranë dhe me MA, nëpërmjet komunikimit telefonik. Pas këtij konsultimi dhe duke marrë parasysh se aktiviteti po zhvillohej në mënyrë të paautorizuar, drejtori ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të ndaluar mbledhjen, në përputhje kjo me detyrimet ligjore për ruajtjen e rendit dhe mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit.

Pretendimi i znj. L. se sindikata e saj është trajtuar ndryshe nga organizatat e tjera sindikale nuk mbështetet në fakte dhe prova. Nuk ka asnjë dokumentim zyrtar që vërteton se FSASH apo SPASH kanë zhvilluar aktivitete të ngjashme në ambientet e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, Tiranë pa autorizim. Po ashtu, nuk rezulton e provuar që znj. L. ka pasur një takim zyrtar me drejtoreshën apo juristen e ZVA Tiraë për këtë çështje. Në këto rrethana vlerësojmë se citimet e saj janë pretendime unilaterale të njëanshme të mbetura në kuadrin deklarativ, e për rrjedhojë janë të paprovuara.

Vendimarrja e drejtorit është e mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi si më poshtë:

- Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton se drejtori është përgjegjës për administrimin dhe garantimin e funksionimit të pandërprerë të procesit mësimor, si dhe për ruajtjen e mjedisit shkollor si hapësirë neutrale dhe e sigurt.
- Rregullorja e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, miratuar nga MAS, e cila kërkon që çdo aktivitet jo-mësimor në ambientet e shkollës të jetë i autorizuar me shkrim nga MAS, ZVA ose drejtorja, në varësi të natyrës së aktivitetit.
- Ligji nr.9775/2007 “Për organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve”, i ndryshuar ku përcaktohet se një organizatë sindikale fiton personalitet juridik vetëm pas regjistrimit gjyqësor dhe pajisjes me certifikatën përkatëse. Pa këtë status juridik, organizata nuk mund të ushtrojë veprimtari institucionale në raport me subjektet publike.
- Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, neni 3/1 dhe 7/1, i cili kërkon që çdo trajtim ndryshe të jetë i pajustificuar dhe të bazohet në një cilësi të mbrojtur. Në këtë rast, vendimi i drejtorit ka qenë i bazuar në standartet e njëjta administrative për të gjithë subjektet që kërkojnë përdorimin e ambienteve të shkollës.

Vendimi për të mos lejuar zhvillimin e aktivitetit është marrë mbi bazën e :

- Mungesës së dokumentacionit ligjor që vërteton ekzistencën dhe përfaqësimin e sindikatës.
- Mungesës së autorizimit nga ZVA ose MAS për përdorimin e ambienteve të shkollës.
- Cenimit të mbarëvajtjes së zhvillimit të procesit mësimor dhe ndërprerjes së orëve; detyrimin institucional për të garantuar neutralitetin dhe sigurinë e mjedisit shkollor.
- Zhvillimit të aktivitetit pa dijeni dhe pa leje të drejtorit;

- Mungesës së povave për trajtim të pabarabartë apo diskriminues.

Në këtë kuadër nuk rezulton të ekzistojë asnjë element i diskriminimit të ndaluar nga ligji nr.10221/2010, pasi vendimi është marrë mbi baza objektive, të ligjshme dhe të zbatueshme për çdo subjekt.

Drejtori i institucionit arsimor Kongresi i Lushnjes Tiranë, ka vepruar në përputhje të plotë me detyrimet ligjore dhe kompetencat që ia njej ligji. Aktiviteti nuk është lejuar për arsye të justifikuar ligjore dhe administrative. Sindikata në fjalë mund të organizojë mbledhje lirisht me mësuesit e shkollës jashtë ambienteve të institucionit, por për të zhvilluar aktivitetin e saj brenda ambienteve të shkollës duhet të pajiset me dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe autorizimin përkatës nga institucionet përgjegjëse.

Dhe për sa kohë që asnjë subjekt:

- nuk është pajisur me leje të veçantë nga titullari i institucionit apo nga organi i tij epror;
- nuk paraqet dokumentacionin përkatës me objekt veprimtarie, organizimin e mësuesve në sindikata;
- nuk do të lejohen të kryejnë asnjë veprimtari në ambientet e shkollës.

Përfundimisht vlerësojmë që veprimet e drejtorit të institucionit arsimor parauniversitar, shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës” Tiranë, kanë qenë tepër korrekte dhe në përputhje të plotë në ushtrimin e detyrës, bazuar kjo, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Europiane për të Drejtat e Njëriut, Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Kodit të procedurave Administrative dhe Rregullores së IA. Bashkëlidhur shkresa nga Ministria e Arsimit datë 10.12.2024 me nr.protokolli 7253/1 mbi përcaktimin se cilat janë sindikatat që njihen dhe duhet të lejohen në ambientet e institucionit arsimor.

4. Me shkresën nr.7778/2 prot., datë 24.12.2025, Ministria e Arsimit, ka kthyer përgjigje duke parashtruar ndër të tjera, si më poshtë:

Ministria e Arsimit me shkresën nr.7778/1 prot., datë 17.12.2025 ka dërguar pranë Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë (DRAP Tiranë) dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë (ZVAP Tiranë) kërkesën për informacion mbi ankesën e paraqitur.

ZVAP Tiranë me shkresën nr.12351/1 prot datë 10.12.2025, i ka kthyer përgjigje Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) duke i bërë me dije që ky institucion nuk ka asnjë praktikë të mbajtur në lidhje me rastin për të cilin SBASH pretendon diskriminim.

Shkolla “Kongresi i Lushnjës” Tiranë, me shkresën nr.169 prot., datë 11.12.2025, drejtuar KMD-së dhe për dijeni Ministrisë së Arsimit, ka parashtruar argumentet mbi pretendimin për diskriminim nga SBASH, mbi moslejimin e kësaj organizate për zhvillimin e aktivitetit me mësuesit në ambientet e kësaj shkolle.

Bazuar në informacionin e përcjellë nga drejtuesi i Shkollës “Kongresi i Lushnjes” Tiranë, konstatohet se vendimi për moslejimin e zhvillimit të aktivitetit të organizatës SBASH me mësuesit brenda ambienteve të kësaj shkolle është marrë, ndër të tjera, referuar dispozitave ligjore të kodit të Punës. Në pikën 7, të nenit 181, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohen liritë sindikale, përcaktohet që punëdhënësi duhet të krijojë kushtet dhe lehtësitë e nevojshme për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave sindikale për ushtrimin noralisht të funksioneve të tyre, të cilat përcaktohen në kontratën kolektive të punës. Për këtë qëllim punëdhënësi duhet:

- a) të lejojë hyrjen e tyre në mjediset e punës;
- b) të lejojë shpërndarjen e njoftimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës sindikale;
- c) t’u japë kohën e nevojshme për të marrë pjesë në veprimtaritë e këtyre organizatave brenda dhe jashtë vendit;
- d) të lejojë dhe t’u krijojë lehtësi në mjediset e punës për grumbullimin e kuotizacioneve të organizatës, si dhe për organizimin e mbledhjeve dhe të takimeve;

Lidhur me pretendimin e përsëritur për diskriminim nga institucionet arsimore dhe ato përgjegjëse për arsimin parauniversitar, SBASH i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjet nga Diskriminimi me ankesën nr.264 regj datë 30.12.2024, i cili për këtë ankesë është shprehur me vendimin nr.142 datë 03.06.2025.

Me kërkesë padinë nr.3472/3 prot., datë 04.07.2025 të MAS drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me të paditur Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi është kërkuar shfuqizimi i pikave 2 dhe 3 të vendimit nr. 142 datë 03.06.2025, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sipas nenit 36 të ligjit nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.

Gjithashtu sipas pikës, 1, të nenit 66, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *“Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës, është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”*.

5. Me e-mail-in e datës 08.01.2026, pala ankuese ka paraqitur prapësimet e saj në lidhje me qëndrimin e subjekteve të mësipërme, duke parashtruar ndër të tjera :

Të tri institucionet shprehen në mënyra të ndryshme lidhur me pretendimin tim për ushtrimin lirshëm të funksioneve të mia si Presidente e SBASH..

Zyra Arsimore Tirane udhëhiqet nga parimi i zbatimit të akteve ligjore si dhe të drejtave të fituara por këto mbeten vetëm fjalë se raliteti është ai që ndeshet në takimet nëpër shkolla.

Ministria e Arsimit nuk shqyrton ankesën pa folur gjykata për mosmarrveshjen civile që do të shqyrtojë gjykata lidhur me vendimin nr 142, datë 03.06.2025, ku ministria ankimon pikën 2 dhe 3 të vendimit të KMD.

Drejtori i shkollës nuk thotë të vërtetën lidhur me takimin tim me mësuesit. Takimin e miratoi drejtori, duke komunikuar më parë me mua, në zyrën e tij.

Më quan të vetdeklaruar si kryetare e SBASH kur unë i vura në dispozicion çdo dokument që më kërkoi. Gjithashtu pati edhe një ndërhyrje të një mësueseje të shkollës në drejtori e cila ishte kundër realizimit të takimit. Ajo pohoi që vetëm SPASH dhe FSASH janë të ligjshëm të bëjnë takime. Mësuesja përfaqësonte FSASH dhe nuk ishte dakord për takimin e mësuesëve me mua.

Drejtori njoftoi mësuesit për takim dhe vetëm pas 7-8 minutash e ndërpreu mbledhjen duke ju thënë mësuesëve se takimi është i paligjshëm dhe sindikata është e paligjshme. Pasi unë i kërkova drejtorit me insistim pse e ndërpreu takimin tim me mësuesit e shkollës dhe pse përdori komunik të papërshtatshëm, Drejtori më pohoi që e morrën në telefon nga ZVA Tiranë për të ndaluar takimin e SBASH.

6. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 20.02.2026. Seanca dëgjimore iu komunikua palëve me shkresën nr. 312 prot., datë 09.02.2026.

Seanca dëgjimore e datës 20.02.2026 u zhvillua me pjesmarrjen e palës ankuese, përfaqësuar nga znj.A.L , Presidente e SBASH, z. M.Xh, Drejtor i Shkollës 9-vjecare “Kongresi i Lushnjes”, Tiranë, Ministrisë së Arsimit (MA), përfaqësuar nga znj.A.K, Përgjegjëse në Sektorin e Monitorimit të Impaktit të Akteve dhe Çështjeve Juridike Administrative, sipas autorizimit nr.1247/1 prot., datë 16.02.2026, lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MA dhe ZVAP Tiranë, përfaqësuar nga Rea Koleci, sipas autorizimit të datës 20.02.2026, të Drejtores së ZVAP Tiranë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, pala ankuese, SBASH, është regjistruar si person juridik duke fituar në këtë mënyrë personalitet juridik, me vendimin nr.3, datë 15.02.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Rezulton se në datën 26.06.2026, znj.A.L , në cilësinë e Presidentes së SBASH, është paraqitur në ambientet e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, Tiranë për të zhvilluar një takim me mësuesit e kësaj shkolle për t’i informuar ata, por edhe për t’u organizuar.

Sipas deklarimeve të palëve të bëra gjatë seancës dëgjimore, konfirmohet se, znj.L. , pasi është paraqitur në ambientet e shkollës ka marrë fillimisht takim me drejtorin z. Xh.. Gjatë këtij takimi, pasi znj.L. e ka informuar se ajo ishte përfaqësuese e një organizate e regjistruar dhe që njihej ligjërisht sipas legjislacionit në fuqi, është lejuar që të zhvillojë takimin me mësuesit e kësaj shkolle.

Pala ankuese pretendon se, pak pasi takimi kishte filluar, një mësuese, e cila më parë ka qenë drejtore e shkollës, filloi të filmonte mësuesit që merrnin pjesë në takim duke krijuar një situatë të tensionuar tek mësuesit.

Pas këtij momenti, rezulton se drejtori i shkollës është futur në takim dhe i ka komunikuar znj. L. , se nuk i lejohej që të zhvillonte takimin. Drejtori i Shkollës deklaroi gjatë seancës dëgjimore, se për shkak se ai ishte i ri në detyrë, detyrë të cilën e kishte marrë në mars të vitit 2025, ka telefonuar një person i cili sipas tij e dinte më shumë se ai për arsimin, duke i parashtruar situatën dhe duke e pyetur nëse ishte e ligjshme. Personi me të cilin ka komunikuar, identiteti i të cilit nuk u deklarua, i ka komunikuar se nuk ishte e ligjshme, pasi ishte në proces gjyqësor Drejtori i shkollës deklaroi gjatë seancës dëgjimore, se nëse do të kishte ndonjë tendencë ndaj sindikatës që përfaqëson znj.Lama, nuk do ta kishte lejuar të futej në shkollë.

Në datën 23.10.2025, znj. L. , Presidente e SBASH, i është drejtuar me e-mail shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, Tiranë (në vijim Shkolla), nëpërmjet të cilit ka kërkuar zhvillimin e një takimi sindikal me mësuesit e shkollës, në përfundim të procesit mësimit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, me e-mail datë 27.10.2025, Drejtori i Shkollës ka kthyer përgjigje, në të cilën parashtron: *“Në zbatim të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 55 dhe 59, përcakton se shkolla është institucion nën juridiksionin e Ministrisë së Arsimit dhe e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë, hyrja e personave të jashtëm bëhet vetëm me miratimin e Ministrisë së Arsimit, si dhe të rregulloreve të brendshme që rregullojnë veprimtarinë në institucionet arsimore publike, ju bëjmë me dije se: çdo vizitë në ambientet e shkollës nga përfaqësues të jashtëm, përfshirë kryetarin e sindikatës, mund të kryhet vetëm pas miratimit dhe njoftimit zyrtar nga Zyra Vendore e Arsimit (ZVA) përkatëse ose Ministria e Arsimit. Për rrjedhojë, drejtoria e shkollës nuk mund të lejojë zhvillimin e vizitës pa autorizimin e Ministrisë së Arsimit, si institucioni përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive të këtij karakteri në institucionet arsimore të varësisë së saj. Ky veprim është në funksion të respektimit të procedurave ligjore, të mbarëvajtjes së procesit mësimit dhe të ruajtjes së rendit institucional në shkollë.”*

Në vijim të kësaj përgjigje, me *e-mailin* e datës 15.11.2025, znj. Lama, i është drejtuar Shkollës që të rishikojë qëndrimin e saj për realizimin e takimit me mësuesit, pasi organizimet sindikale janë të lira dhe organizatatave ju krijohen kushte pa diskriminim. Nga ana e Shkollës nuk ka patur përgjigje.

Pala ankuese ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi nr. 270 Regj., datë 21.11.2025, kundër Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë, duke pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme në gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave sindikale, për shkak se nuk është një oraganizatë sindikale nënshkruese e kontratës Kolektive të Punës me MA, krahasimisht me sindikatat që janë nënshkruese të Kontratës Kolektive me MAS. Pala ankuese pretendon se është diskriminuar, për shkak se nuk lejohet që të ushtrojë veprimtarinë sindikale si organizatë sindikale në mjediset e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë, duke mos iu krijuar kushtet dhe duke iu mohuar lehtësitë e parashikuara sipas Kodit të Punës.

- *Kuadri ligjor dhe standardet e zbatueshme.*

Liria e organizimit, njihet nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, si një të drejtë themelore të njeriut. E drejta për t’u organizuar në sindikatë sanksionohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si një nga të drejtat themelore të njeriut. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 50 të saj, sanksionon se: *“Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës.”*, duke njohur të drejtën që kushdo, çdo punëmarrës, ka të drejtë të marrë pjesë lirisht apo të jetë anëtar i një apo disa organizatave sindikale në mënyrë që të garantojë mbrojtjen e interesave të lidhura me punën, ndërmjet të cilave edhe fitimin e mjeteve të jetesës me një punë të denjë dhe të ligjshme. Megjithatë sanksionimi i kësaj dispozite nuk do të thotë se punëmarrësi është i detyruar të jetë anëtar i një apo disa organizatave sindikale, përkundrazi kjo është një e drejtë ekskluzive e punëmarrësit për të vendosur vullnetarisht në lidhje me pjesëmarrjen ose jo në një organizatë sindikale.

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, sanksionon të drejtën për tu organizuar në sindikata. Në nenin 1, Konventa sanksionon:

“Neni 11

Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në njëshoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.”

Parimi i lirisë së organizimit, i cili është një parim i njohur botërisht, gjendet në burime të shumta ndërkombëtare. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948, në nenin 23, pika 4, njeh të drejtën për të formuar dhe për t'u anëtarësuar në sindikata.

Në kuadër të akteve detyruese të Kombeve të Bashkuara, kjo e drejtë është njohur si në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ashtu edhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Konkretisht, neni 22, i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike përcakton se: *“1. Gjithsecili ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e lirisë së organizimit me të tjerët, përfshirë të drejtën për të formuar dhe për t'u anëtarësuar në sindikata për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund t'i nënshtrohet asnjë kufizimi përveç kufizimeve të parashikuara nga ligji dhe të cilat janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, rendit publik, mbrojtjes së shëndetit ose moralit publik ose mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”* ndërsa neni 8 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përcakton se: *“1. Shtetet Palë në këtë Pakt marrin përsipër të sigurojnë: a) të drejtën e gjithsecilit për të formuar sindikata dhe për t'u anëtarësuar në sindikata sipas zgjedhjes së tij, duke iu nënshtruar vetëm rregullave të organizatës në fjalë, për promovimin dhe mbrojtjen e interesave të tij ekonomike dhe shoqërore. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund t'i nënshtrohet asnjë kufizimi përveç kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe të cilat janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare ose rendit publik ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. b) E drejta e sindikatave për të krijuar federata ose konfederata kombëtare dhe e drejta e këtyre të fundit për të formuar ose për t'u anëtarësuar në organizata sindikale ndërkombëtare. c) E drejta e sindikatave për të funksionuar lirshëm pa asnjë kufizim përveç kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe të cilat janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare ose rendit publik ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. 3) Asnjë dispozitë në këtë nen nuk i autorizon Shtetet Palë të Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës të vitit 1948 në lidhje me Lirinë e Organizimit dhe Mbrojtjen e të Drejtës për t'u Organizuar për marrjen e masave legislative që mund të çënonjnë, ose të zbatojnë ligjin në një mënyrë të tillë që do të çëronte, garancitë e parashikuara në atë Konventë”*.

Parimi i lirisë së organizimit është pjesë e Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Dy nga instrumentat e ILO-s, që vendosin detyrime ligjore mbi Shtetet, në lidhje me lirinë e organizimit të punonjësve, janë Konventa për Lirinë e Organizimit dhe Mbrojtjen e së Drejtës për t'u Organizuar, 1948 (Nr. 87) dhe Konventa për të Drejtën e Organizimit dhe Bisedime Kolektive, 1949 (Nr. 98). Shqipëria është një vend anëtar i ILO dhe ka ratifikuar të dy këto konventa thelbësore të ILO në lidhje me lirinë e orgnaizimit.

Konventa për Lirinë e Organizimit dhe Mbrojtjen e së Drejtës për t'u Organizuar, 1948 (Nr. 87). Disa nga përcaktimet e kësaj Konvente që paraqesin rëndësi në kuadër të shqyrtimit të çështjes janë: *“Neni 2*

Punëtorët dhe punëdhënësit, pa asnjë dallim, kanë të drejtë të themelojnë dhe, sipas rregullave të organizatës përkatëse, të bashkohen në organizata të zgjedhjes së tyre, pa pasur nevojë për autorizim paraprak.

Neni 3

Organizatata e punëtorëve dhe të punëdhënësve kanë të drejtë të hartojnë statutin dhe rregullat e tyre, të zgjedhin përfaqësuesit në liri të plotë, të organizojnë administrimin dhe aktivitetet e tyre dhe të formulojnë programet përkatëse.

Autoritetet publike duhet të përmbahen nga çdo ndërhyrje që do të kufizonte këtë të drejtë ose do të pengonte ushtrimin e saj të ligjshëm.

Neni 8

Gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara në këtë Konventë, punëtorët, punëdhënësit dhe organizatat e tyre, sikurse çdo person apo kolektiv i organizuar, duhet të respektojnë ligjin e vendit. Ligji i vendit nuk duhet të cenojë, as të zbatohet në mënyrë që cenon garancitë e parashikuara në këtë Konventë.

Neni 11

Çdo Shtet Anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës që ka ratifikuar këtë Konventë angazhohet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që punëtorët dhe punëdhënësit të ushtrojnë lirisht të drejtën për organizim.”

Konventa për të Drejtën e Organizimit dhe Bisedime Kolektive, 1949 (Nr. 98). Disa nga përcaktimet e kësaj Konvente që paraqesin rëndësi në kuadër të shqyrtimit të çështjes janë:

“Neni 1

- 1. Punëtorët duhet të gëzojnë mbrojtje të mjaftueshme kundër veprimeve të diskriminimit sindikal në lidhje me punësimin e tyre.*
- 2. Kjo mbrojtje zbatohet veçanërisht ndaj veprimeve që kanë për qëllim:
(a) vendosjen e punësimit të një punëtori me kusht që ai të mos anëtarësohet në një sindikatë ose të heqë dorë nga anëtarësimi sindikal; (b) shkarkimin ose dëmtimin ndryshe të një punëtori për shkak të anëtarësisë në një sindikatë apo për pjesëmarrje në aktivitete sindikale jashtë orarit të punës, ose me pëlqimin e punëdhënësit, edhe gjatë orarit të punës.*

Neni 2

- 1. Organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve duhet të gëzojnë mbrojtje të mjaftueshme ndaj çdo ndërhyrjeje nga njëri-tjetri ose nga agjentët apo anëtarët e njëri-tjetrit sa i takon themelimit, funksionimit ose administrimit të tyre.*
- 2. Veçanërisht, veprimet që synojnë krijimin e organizatave të punëtorëve nën kontrollin e punëdhënësve apo organizatave të tyre, ose mbështetjen e tyre përmes financimit apo mjeteve të tjera me qëllim vendosjen e kontrollit nga punëdhënësit, do të konsiderohen si ndërhyrje sipas kuptimit të këtij neni.*

Neni 3

Duhet të krijohen mekanizma të përshtatshëm me kushtet kombëtare, aty ku është e nevojshme, për të siguruar respektimin e të drejtës për t'u organizuar siç përcaktohet në nenet e mësipërme.

Neni 4

Duhet të ndërmerren masa të përshtatshme me kushtet kombëtare, aty ku është e nevojshme, për të inkurajuar dhe promovuar zhvillimin e plotë dhe përdorimin e mekanizmave për negociata vullnetare ndërmjet punëdhënësve ose organizatave të tyre dhe organizatave të punëtorëve, me qëllim rregullimin e kushteve të punës përmes marrëveshjeve kolektive.”

Karta Sociale Europiane (e rishikuar), gjithashtu përmban parashikime për të drejtën për t'u organizuar dhe mbi të drejtën për të negociuar kolektivisht. Dispozitat që paraqesin rëndësi në kuadër të shqyrtimit të çështjes janë:

“Neni 5

E drejta për t'u organizuar

Me synimin për të siguruar dhe nxitur lirinë e punëtorëve dhe punëdhënësve për të formuar organizata lokale, kombëtare ose ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike dhe sociale dhe për t'u anëtarësuar në ato organizata, Palët angazhohen që legjislacioni kombëtar nuk do të jetë i tillë që të pengojë dhe as do të zbatohet që të pengojë këtë liri.

Neni 6

E drejta për të negociuar kolektivisht

Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për të negociuar kolektivisht, Palët angazhohen: 1. të nxisin konsultimet e përbashkëta ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve; 2. të nxisin, ku është e nevojshme dhe e përshtatshme, mekanizmin për negociata vullnetare ndërmjet punëdhënësve ose organizatave të punëdhënësve dhe organizatat e punëtorëve, me synimin për rregullimin e termave dhe kushteve të punësimit me anë të marrëveshjeve kolektive;.....”

Organizatave sindikale, si organizata të punëmarrësve, dhe liria sindikale mbrohen me ligj dhe një gjë e tillë përcaktohet shprehimisht në nenin 10 të Kodit të Punës, i cili sanksionon: *“1.Liria sindikale mbrohet me ligj. 2.Askush nuk ka të drejtë:a) të kushtëzojë punësimin e punëmarrësit,nëse ai është ose jo,ose pushon së qënuri anëtari i një sindikate të krijuar në bazë të ligjit;b) të pushojë ose cenojë të drejtën e punëmarrësit për shkak të anëtarësimi,ose jo në një sindikatë të krijuar në bazë të ligjit,ose të pjesëmarrjes në veprimtari sindikale duke respektuar legjislacionin në fuqi.”*

Përkufizimi i organizatave sindikale, krijimi dhe funksionimi i tyre, liritë sindikale dhe ndalimi i ndërhyrjeve në veprimtarinë e sindikatave, gjejnë rregullim në Kodin e punës. Dispozitat që paraqesin rëndësi në këtë drejtim janë:

Neni 163, “Kërkesa për Bisedime për Lidhjen e Kontratës Kolektive”, pika 3, përcakton se: “3. Kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive bëhet me shkrim. Ajo shoqërohet me kopjen e statutit të organizatës ose organizatave kërkuese sindikale, si dhe me treguesit e nevojshëm mbi përfaqësueshmërinë e këtyre të fundit në ndërmarrje, ndërmarrjet ose degën e caktuar.”

Neni 176, “Organizatave sindikale dhe organizatat e punëdhënësve”, përcakton se: “1. Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata shoqërore të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre”.

Neni 178, “Fitimi i Personalitetit Juridik”, parashikon se: “1. Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve, federatat dhe konfederatat duhet të dorëzojnë aktin e krijimit dhe statutin e tyre në Gjykatën e Tiranës për njohjen e tyre si person juridik.”

Neni 181, “Parimet”, parashikon: “1. Organizata sindikale organizon lirisht administrimin dhe veprimtarinë e saj; ajo harton lirisht programin e saj. 2. Çdo organizatë sindikale duhet të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.....7. Punëdhënësi duhet të krijojë kushte dhe lehtësitë e nevojshme për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave sindikale për ushtrimin normalisht të funksioneve të tyre, të cilat përcaktohen në kontratën kolektive të punës. Për këtë qëllim punëdhënësi duhet:

a) të lejojë hyrjen e tyre në mjediset e punës;

b) të lejojë shpërndarjen e njoftimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës sindikale;

c) t'u japë kohën e nevojshme për të marrë pjesë në veprimtaritë e këtyre organizatave brenda dhe jashtë vendit;

ç) të lejojë dhe t'u krijojë lehtësi në mjediset e punës për grumbullimin e kuotizacioneve të organizatës, si dhe për organizimin e mbledhjeve dhe të takimeve.....”

Neni 182, “Mbrojtja e të drejtave të anëtarëve në gjykatë” parashikon: “Çdo organizatë sindikale e njohur si person juridik mund t'i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e interesave të secilit prej anëtarëve të saj, për të arritur zbatimin nga punëdhënësi të dispozitave të ligjit, kontratës kolektive ose individuale të punës.”

Neni 184, “Parimet”, parashikon: “1. Ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave profesionale nga organet shtetërore. 2. Ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave sindikale nga punëdhënësit ose organizatat e punëdhënësve.”

Neni 185, “Veprimet e ndërhyrjes së organit shtetëror”, parashikon: “1. Organi shtetëror nuk ndërhyr për raste që kufizojnë të drejtat e parashikuara në nenin 182 të këtij Kodi, ose që pengojnë ushtrimin e tyre ligjor, me përjashtim të rasteve të shkeljeve të ligjshmërisë. 2. Organizata sindikale mund t’i drejtohet gjykatës për të ndaluar çdo veprim ndërhyrjeje ose kërcënimi ndaj saj.”

Neni 186, “Veprimet e ndërhyrjes së punëdhënësit ose të një organizate punëdhënësish”, parashikon:

“1. Konsiderohen si veprime ndërhyrjeje të punëdhënësit ose të një organizate punëdhënësish masat që:

a) nxisin krijimin e organizatave sindikale që mbizotërohen nga një punëdhënës ose një organizate punëdhënësish ose që mbështesin organizata sindikale me mjete financiare apo mënyra të tjera, me qëllim që t’i vendosin këto organizata nën kontrollin e një punëdhënësi ose organizate punëdhënësish;

b) pengojnë krijimin, funksionimin ose administrimin e një organizate sindikale;

c) dëmtojnë punëmarrësin për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë së tij sindikale, duke e diskriminuar atë.”

Vlerësimi i Komisionerit.

Sa më sipër rezulton e provuar se, pala ankuese SBASH, një organizatë sindikale, e cila ka fituar personalitet juridik duke u regjistruar në Gjykatë, nuk është lejuar që të ushtrojë liritë sindikale duke mos u lejuar që të organizojë takime dhe të zhvillojë veprimtari informuese sindikaliste në mjediset e shkollës “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë.

Komisioneri konstaton se, arsyet e dhënë nga ana e Drejtuesit të Shkollës për mos lejimin e zhvillimit të takimeve sindikale në mjedisin e punës (në shkollë), janë kontradiktore. Në parashtrimet me shkrim të depozituara gjatë shqyrtimit të ankesës nr.169 prot., datë 11.12.2025, Drejtori i Shkollës fillimisht pretendon se znj.Lama, në datën 26.06.2025 ka hyrë në ambientet e Shkollës pa lejen e drejtorit, ndërsa gjatë seancës dëgjimore deklaroi se takimi ishte lejuar fillimisht prej tij, për tu ndaluar më pas për shkak se u konsideruar i paligjshëm, për shkak të një procesi gjyqësor. Drejtori i Shkollës pretendoi gjithashtu se nga ana e palës ankuese nuk ishte paraqitur vendimi i regjistrimit, një arsye kjo sipas tij që nuk lejonte zhvillimin e takimit. Gjatë seancës dëgjimore, nga ana e Drejtorit të Shkollës u deklarua se në rast se pala ankuese paraqiste vendimin e regjistrimit në gjykatë, ajo mund të zhvillonte takimin me mesuesit në ambientet e shkollës.

Në parashtrimet me shkrim të depozituara nëpërmjet shkresës nr.169 prot., datë 11.12.2025, Drejtori i Shkollës deklaroi se, vendimi për të mos lejuar aktivitetin është marrë mbi bazën e mungesës së autorizimit nga ZVAP Tiranë ose MA, për përdorimin e ambienteve të Shkollës. Nevojën për një miratim dhe njoftim zyrtar nga ZVAP dhe MA, për të lejuar zhvillimin e një aktiviteti nga përfaqësues të organizatave sindikale, Drejtori e Shkollës e parashtron edhe në përgjigjen që i ka kthyer palës ankuese me e-mailin datë 27.10.2025, nëpërmjet të cili i refuzon zhvillimin e një takimi sindikal të kërkuar për në datën 28.11.2025. Në parashtrimet e datës 11.12.2025, Drejtori i Shkollës

thekson se, sindikatat që njihen dhe duhet të lejohen në ambientet e institucionit arsimor, përcaktohen në shkresën nr.7253/1 prot., datë 10.12.2024, të Ministrisë së Arsimit.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, ZVAP Tiranë parashtrori se, nuk ka një praktikë të mbajtur për rastet që janë objekt shqyrtimi. ZVAP Tiranë sqaroi se, është në kompetencën e çdo drejtori të institucionit arsimor menaxhimi dhe funksionim i institucionit arsimor që ai drejton, për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndërsa në shkresën nr.12651/1 prot., datë 10.12.2025 ZVAP Tiranë, parashtron se, në veprimtarinë e saj të përditshme udhëhiqet nga parimi i zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe respektimin e të gjitha të drejtave të njohura dhe të fituara nga çdo sindikatë e arsimit, që operon dhe funksionon në fushën e arsimit parauniversitar, gjatë seancës dëgjimore, parashtrori se, një organizatë sindikale e cila nuk ka nënshkruar kontratë kolektive me ministrinë, nuk ka të drejtë të ushtrojë liritë sindikale në mjedisin e punë, pra në ambientet e institucionit arsimor, dhe se, Drejtori i Shkollës ka vepruar drejt duke mos e lejuar palën ankuese që të zhvillojë takimin në ambientin e shkollës.

Ministria e Arsimit, duke evidentuar faktin se, vendimi i Drejtorit të Shkollës për moslejimin e zhvillimit të aktivitetit të organizatës SBASH me mësuesit brenda ambienteve të kësaj shkolle është marrë, ndër të tjera, referuar ligjore të Kodit të Punës, konkretisht pikës 7, të nenit 181, pretendon se, procedura për shqyrtimin e ankesës objekt shqyrtimi, nuk duhet të vijojë, bazuar në nenin 36, të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 66, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, me arsyetimin se, për pretendimin e përsëritur për diskriminim nga institucionet arsimore dhe ato përgjegjëse për arsimin parauniversitar, pala ankuese SBASH i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjet nga Diskriminimi me ankesën nr.264 regj datë 30.12.2024, për të cilën Komisioneri është shprehur me vendimin nr.142 datë 03.06.2025. Me kërkesë padinë nr.3472/3 prot., datë 04.07.2025 të MAS drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me të paditur Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi është kërkuar shfuqizimi i pikave 2 dhe 3 të vendimit nr. 142 datë 03.06.2025, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri e gjen këtë pretendim të MA, të pabazuar, për arsyet e mëposhtme:

Në nenin 36, të Kodit të Procedurës Civile sanksionohet se: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.”*, ndërsa neni 66, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikon: *“1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.”*

Rastet e pretenduara si diskriminuese të cilat janë objekt shqyrtimi në kuadër të kësaj ankese, nuk rezultojnë të jenë marrë në shqyrtim në vendimin nr.142 datë 03.06.2025, të Komisionerit. Në këto kushte, pretendimet objekt i kësaj ankese, nuk janë në shqyrtim nga ana e Gjykatës, në kuadër të kontrollit administrativ që ushtrohet ndaj vendimmarrjes së Komisionerit, konkretisht vendimit

nr.142, datë 03.06.2025. Vetë LMD, në nenin 33, pika 4, germa “c”, ndalon Komisionerin që të marrë në shqyrtim një ankesë në kushtet kur e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.

Në kuadër të procedurës për shqyrtimin e kësaj ankese, nuk konstatohet ndonjë çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e kësaj procedure dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, nga çështja objekt shqyrtimi, për zgjidhjen e së cilës është kompetente gjykata. Çështja e moslejimit të palës ankuese për të zhvilluar aktivitet sindikal në mjedisin e punës, pra në institucionin arsimor, është një çështje e përsëritur, pasi Komisioneri ka konstatuar edhe raste të tjera, kur pala ankuese SBASH është diskriminuar për shkak se nuk është një organizatë sindikale e cila nuk ka nënshkruar kontratë kolektive me Ministrinë e Arsimit, duke mos u lejuar që të zhvillojë aktivitet sindikal në mjediset e punës, pra në shkollë², por situatat dhe momentet konkrete të pretenduara diskriminuese, përbëjnë momente të ndryshme dhe që nuk ndërvaren nga njëra tjetra.

Pavarësisht faktit se një çështje e ngjashme mund të jetë duke u shqyrtuar nga gjykata administrative kompetente, kjo rrethanë nuk përbën pengesë ligjore për ushtrimin e kompetencave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili gëzon të drejtën dhe detyrimin për të dalë me një vendim për raste të reja. Nuk mund të barazohet fakti që problematika është e njëjtë, pra moslejimi i palës ankuese për të zhvilluar aktivitet sindikal në mjedisin e punës, pra në shkollë, me sjelljen konkrete të pretenduar si diskriminuese, të cilat janë të ndryshme, pavarësisht se mund të përfshihen të njëjtat palë. Sjellja diskriminuese mund të jetë edhe e përsëritur, por kjo nuk do të thotë që situata e përsëritur e diskriminimit nuk duhet të merret në shqyrtim, nga ana e Komisionerit. Kjo do të sillte si pasojë cenimin e të drejtës së palës ankuese.

Rezulton plotësisht e provuar se, sjellja diskriminuese e pretenduar në kuadër të ankesës objekt shqyrtimi, nuk është shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër apo të ketë një vendimmarrje nga Komisioneri, apo që e njëjta sjellje objekt i kësaj ankese të jetë duke u shqyrtuar nga ana e gjykatës.

Njëkohësisht, referuar dispozitave të nenit 28 dhe 30 të Ligjit nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, paraqitja e një ankimi ose padie administrative nuk pezullon automatikisht efektet juridike të aktit administrativ të kundërshtuar, përveçse në rastet kur gjykata administrative ka vendosur ndryshe përmes marrjes së masës së sigurimit të padisë, sipas neneve të këtij ligji.

Në këtë kuptim, deri në momentin kur një vendim gjyqësor i formës së prerë ose një masë sigurimi e padisë ka pezulluar zbatimin e aktit administrativ, akti vazhdon të prodhojë pasoja juridike, dhe organet administrative, përfshirë Komisionerin, janë të detyruara të ushtrojnë kompetencat e tyre

² Shiko: Vendimi nr. 142 datë 03.06.2025 dhe Vendimi nr.8, datë 13.01.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

ligjore në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të ligjshëm, përfshirë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në Vendimin nr. 00-2025-3248, datë 25.09.2025 ka arsyetuar se: *“Paraqitja e padisë administrative për kundërshtimin e një akti administrativ të ekzekutueshëm nuk sjell pezullimin automatik të ekzekutimit të tij dhe as të procedurës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, pasi vendimi përfundimtar i organit më të lartë administrativ përbën titull ekzekutiv të zbatueshëm menjëherë; vetëm gjykata që shqyrton padinë ka kompetencën të disponojë pezullimin e ekzekutimit përmes marrjes së masës së sigurimit të padisë, ndërsa mungesa e një vendimi të tillë nuk përbën pengesë ligjore për vijimin e ekzekutimit dhe për ushtrimin e kompetencave përkatëse nga organet administrative.”*

Gjatë seancës dëgjimore, MA, parashtroi se qëndrimi i Ministrisë në lidhje me çështjen pasqyrohet në shkresën nr. 7253/1 prot datë 10.12.2024, sipas të cilës, liritë sindikale të parashikuara në nenin 181, pika 7, të Kodit të Punës zbatohen vetëm për organizat sindikale që kanë nënshkruar kontratë kolektive me Ministrinë e Arsimit.

Rezulton se, me shkresën nr. 7253/1 prot daë 10.12.2024, të MAS ka bërë me dije institucionet e saj të varësisë Agjencianë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe dy organizatave nënshkruese të kontratës kolektive të punës Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), se liritë sindikale të parashikuara në nenin 181, pika 7 të Kodit të Punës, janë të zbatueshme nga këto palë. Kjo përgjigje e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), ka ardhur në vijim të ankesës së datës 18.11.2024, që sindikatat nënshkruese të kontratës kolektive të punës SPASH dhe FSASH kanë kërkuar nga MAS, që të mos lejojë hyrjen në mjediset e punës të organizatave të tjera sindikale të cilat nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me ministrinë.

Nëpërmjet një tjetër shkrese, konkretisht shkresës nr. 1721/1 prot datë 13.3.2025, me lëndë *“Përcillet për njohje dhe zbatim kërkesa për zbatimin e Kodit të Punës dhe Kontratës Kolektive”*, MAS, i është drejtuar institucioneve të saj të varësisë dhe konkretisht, AKAP, DRAP Tiranë, Durrës, Fier, Korçë dhe Lezhë, si dhe ZVAP-ve, duke bërë me dije një tjetër ankesën që FSASH dhe SPASH kanë depozituar në MAS. Ndër të tjera nëpërmjet kësaj ankese, dy sindikatat nënshkruese të kontratës kolektive të punës me MAS, FSASH dhe SPASH kërkojnë që ZVAP-të dhe drejtuesit e institucioneve arsimore (IAP) të mos lejojnë hyrjen në mjediset e punës të sindikatave të tjera sindikale që kanë fituar personalitet juridik, por nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me MAS.

Shqetësimin e saj për moslejimin e ushtrimit të lirisë sindikale në mjedisin e punës, pala ankuese e ka ngritur pranë MAS, që prej krijimit të saj. Pas krijimit të saj, pala ankuese në datën 2.4.2024, ka paraqitur shqetësimet e saj për ndërhyrjen në ushtrimin e lirisë sindikale nga ana e ZVAP Tiranë dhe drejtuesve të disa shkollave, të cilët nuk njihnin legjitimitetin e saj si sindikatë dhe nuk lejonin aksesin e saj në mjedisin e punës.

Në vijim të kësaj ankese, fillimisht, me shkresën nr. 2273/1 prot, datë 14.5.2024, të MAS i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), duke kërkuar përcjelljen për njohje dhe informim tek institucionet e varësisë, kërkesën e SBASH. Ndërkohë pas, ankesave të paraqitura nga dy organizatave nënshkruese të kontratës kolektive të punës Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), MAS, ka udhëzuar institucionet e varësisë që të mos lejojnë hyrjen në mjediset e punës (në institucionet arsimore) të sindikatave sindikale që nuk janë nënshkruese të kontratës kolektive me MAS.

Rezulton se, vendimi i Drejtorit të Shkollës për të moslejuar palën ankuese që të zhvillojë takimet sindikale në datën 26.06.2025 dhe refuzimin në datën 27.10.2025 të takimit të kërkuar nga pala ankuese, bazohet në interpretimin që i bëhet nenit 181, pika 7, të Kodit të Punës, në shkresën nr. 7253/1 prot datë 10.12.2024, të MAS, se liritë sindikale të parashikuara nga neni 181, pika 7, të Kodit të Punës janë vetëm për sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të Punës me Ministrinë e Arsimit. Në vijim, konkretisht me shkresën nr. 1721/1 prot datë 13.3.2025, me lëndë “*Përcillet për njohje dhe zbatim kërkesa për zbatimin e Kodit të Punës dhe Kontratës Kolektive*”, MAS, duke përcjellë tek institucionet e saj të varësisë dhe konkretisht, AKAP, DRAP Tiranë, Durrës, Fier, Korçë dhe Lezhë, si dhe ZVAP-ve, ankesat dhe kërkesat e dy organizatave nënshkruese të kontratës kolektive të punës me Ministrinë e Arsimit, FSASH dhe SPASH, të cilat kërkojnë që ZVAP-të dhe drejtuesit e institucioneve arsimore (IAP) të mos lejojnë hyrjen në mjediset e punës të sindikatave të tjera sindikale që kanë fituar personalitet juridik, por nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me MAS, ka udhëzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë institucionet e saj të varësisë për të mos lejuar ushtrimin e lirive sindikale të mjedisin e punës nga ana e organizatave që nuk janë nënshkruese të kontratës kolektive, sikurse pala ankuese. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se ankesat e paraqitura nga FSASH dhe SPASH, të cilat janë përcjellë nga Ministria e Arsimit tek institucionet e varësisë referojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek pala ankuese dhe kërkojnë pikërisht moslejimin e saj për të zhvilluar aktivitetet sindikal në mjediset e shkollës.

Komisioneri arrin në përfundimin se SBASH është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, lidhur me ushtrimin e lirisë sindikale, duke mos u lejuar që të hyjë në ambientet e punës (në mjediset e shkollave) dhe të organizojë takime dhe të zhvillojë veprimtari informuese.

B. Shkaku i mbrojtur

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për shkak të *përkatësisë në një grup të veçantë* dhe *çdo shkak tjetër*.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, Komisioneri vlerëson se “*përkatësia në një grup të veçantë*”, konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”, Komisioneri çmon të evidentojë se:

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është një listë e mbyllur, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “çdo shkak tjetër” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “çdo shkak tjetër” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9 të tij “Ndalimi i diskriminimit”, parashikon : “Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”

Pala ankuese nuk ka përcaktuar në ankesë dhe parashtrimet e saj shpjegime të veçanta për secilin prej shkaqeve diskriminuese të pretenduara nga ana e saj. Referuar pretendimeve të parashtruara nga pala ankuese, rezulton se, pretendimi për diskriminim konsiston në diferencën në trajtim dhe trajtimin më pak të favorshëm që bëhet në gëzimin e lirive sindikale midis palës ankuese e cila nuk është nënshkruese e një kontrate kolektive pune me MA dhe sindikatave të cilat janë nënshkruese të kontratës kolektive të punës me MA.

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizime se çfarë është shkak i mbrojtur. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.³ Gjykata ka theksuar se fjalës "shkak/status tjetër" në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.⁴ Interpretimi i këtij nocioni “nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme”.⁵

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të

³ Shih: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 55; Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës, prg 56; Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 61 dhe 70; Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë, prg. 90.

⁴ Shih: Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 70.

⁵ Shih: Biao kundër Danimarkës, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.

Duke u bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, diferenca në trajtim midis palës ankuese si organizatë sindikale që nuk ka nënshkruar një kontratë kolektive pune me MA dhe organizatave sindikale të cilat janë nënshkruese të kontratës kolektive me MA, gëzon mbrojtje në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*”, sipas parashikimit të nenit 1 të LMD dhe se, ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat tregojnë se pala ankuese e mbart shkakun e mbrojtur.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.*

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 50 të Kushtetutës.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene Kodin e Punës, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme⁶.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

LMD parashikon dhe jep përkufizimin e disa formave nëpërmjet të cilave shfaqet diskriminimi. Referuar nenit 3, pikat 2 dhe 15, të LMD, përcaktohet se: *“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.....15. “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”*

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlijet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përlijjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

⁶ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁷. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁸. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁹

Në të njëjtën frymë edhe në bazë të LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*

Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit në punësim dhe profesion e bën edhe Kodi i Punës, duke sanksionuar në nenin 9, pika 10, të tij se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*, si dhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82,

⁷ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁸ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

⁹ Shih: *Biao kundër Danimarkës*, *Dhoma e Madhe*, datë 14.05.2016, § 89, *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Dhoma e Madhe* 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

pika 2, si vijon : “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin¹⁰.

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara.*”¹¹ Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme

¹⁰ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹¹ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.

GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t'i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ shprehet se: “..... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndaren e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.”¹²

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ka mbajtur qendrimin se: “...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë *prima facie* ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.”

Bazuar në përkufizimin që bën ligji për diskriminimin e drejtëpërdrejtë si një nga format e shfaqjes së sjelljeve diskriminuese, elementët kryesorë ose kyç që duhen vërtetuar janë si më poshtë:

- (i) pala ankuese është trajtuar në mënyrë të të padrejtë dhe të pafavorshme në krahasim me mënyrën se si trajtohen, janë trajtuar apo do të trajtoheshin të tjerët, në një situatë të ngjashme;
- (ii) shkaku i pretenduar i diskriminimit nga pala ankuese është një “shkak i mbrojtur” sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;
- (iii) dhe arsyeja për këtë është shkaku i pretenduar i diskriminimit.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, SBASH është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, duke mos u lejuar që të hyjë në ambientet e punës (në mjediset e shkollës) dhe të organizojë takime dhe të zhvillojë veprimtari informuese. Rezultoi e provuar se diferenca në trajtim

¹² GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

dhe trajtimi i disfavorshem të cilit i është nënshtuar pala ankuese, bazohet në faktin se, SBASH nuk është organizatë sindikale e cila ka nënshkruar kontratë kolektive pune me MA. Në kushtet, kur, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, pala ankuese SBASH, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshem, diferencë kjo e cila bazohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë në faktin se SBASH nuk është organizatë nënshkruese e kontratës kolektive të punës me MAS, rezulton e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshem. Në këto kushte, mbetet që të vlerësohet nëse për këtë diferencë në trajtim ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Komisioneri e gjen të pabazuar në Kodin e Punës pretendimin se, liritë sindikale të parashikuara në nenin 181, pika 7, të Kodit të Punës, parashikohen vetëm për organizatat sindikale të cilat kanë nënshkruar një kontratë kolektive pune me MA.

Neni 181 i Kodit të Punës merret me liritë sindikale të të gjitha sindikatave dhe nuk bën një ndarje në trajtim apo në status midis sindikatave nënshkruese të një kontrate kolektive apo jo. Prandaj, edhe parashikimet e tij merren me rregullimin e të gjithë aktivitetit sindikal dhe garancitë që duhet të ketë. Për këtë arsye Neni 181 përcakton ekspresivisht edhe kushtet dhe lehtësitë e nevojshme që çdo sindikatë duhet ti garantohet nga punëdhënësi, pavarësisht nëse është nënshkruese ose jo e një kontrate kolektive. Sipas këtij neni punëdhënësi duhet:

- a) të lejojë hyrjen e tyre në mjediset e punës;
- b) të lejojë shpërndarjen e njoftimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës sindikale;
- c) t'u japë kohën e nevojshme për të marrë pjesë në veprimtaritë e këtyre organizatave brenda dhe jashtë vendit;
- d) të lejojë dhe t'u krijojë lehtësi në mjediset e punës për grumbullimin e kuotizacioneve të organizatës, si dhe për organizimin e mbledhjeve dhe të takimeve

Sa më sipër, referuar interpretimit dhe frymës së nenit 181, pika 7 e Kodit të Punës, ky nen nuk e kushtëzon ushtrimin e të drejtave sindikale me faktin e të qenit palë nënshkruese e kontratës kolektive, por i referohet kësaj të fundit vetëm si instrument rregullues për mënyrën e ushtrimit të disa marrëdhënieve ndërmjet sindikatës apo sindikatave dhe punëdhënësit.

Ky interpretim është në përputhje me frymën e Kodit të Punës dhe me parimin e trajtimit të barabartë të sindikatave që veprojnë në të njëjtin sektor, duke shmangur krijimin e avantazheve ose disavantazheve të pajustificuara për shkak të statusit formal të nënshkrimit të kontratës kolektive.

Nëse do të pranohej logjika sipas së cilës vetëm sindikatat nënshkruese gëzojnë të drejta minimale për ushtrimin e aktivitetit sindikal, kjo do të vendoste në mënyrë të qartë në pozicion të pafavorshem sindikatat jonënshkruese, edhe në rastet kur ato përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm punëmarrësish, duke u mohuar atyre elementë thelbësorë të veprimtarisë sindikale vetëm për shkak të mosnënshkrimit të kontratës kolektive. Një qasje e tillë do të binte ndesh me nenin 181 të Kodit

të Punës, me parimet kushtetuese të lirisë së organizimit sindikal dhe me vetë logjikën e kontratës kolektive si instrument rregullues dhe jo përjashtues.

Gjithashtu, për sa kohë që përcaktimet e pikës 13.15, të Kontratës Kolektive të Punës të datës 09.06.2023, të nënshkruar midis MAS dhe organizatave sindikale SPASH dhe FSASH, interpretohen dhe zbatohen në mosrespektim me dispozitat e Kodit të Punës, i cili në hierarkinë e normave juridike që normojnë marrëdhënien e punës, në referim të nenit 11 të këtij Kodi. Këto parashikime të Kontratës Kolektive të Punës, nuk mund të shërbejnë si një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm për diferencën në trajtim ndaj të cilës është ekspozuar pala ankuese, e cila nuk është nënshkruese e kontratës kolektive të punës me MAS, në ushtrimin e lirive sindikale, në raport me organizatat e tjera nënshkruese të kontratës kolektive të punës me MAS.

Në këtë kuptim, kontrata kolektive shërben si burim normativ për rregullimin e aktivitetit sindikal në sektorin përkatës si dhe për detajime të mëtejshme të këtij aktiviteti, por jo si kriter për përjashtimin e sindikatave që nuk janë palë nënshkruese. Për rrjedhojë, pavarësisht nëse një sindikatë është apo jo nënshkruese e kontratës kolektive, marrëdhëniet e saj me punëdhënësin për ushtrimin e aktivitetit sindikal duhet të rregullohen sipas parimeve dhe standardeve të parashikuara në Kodin e Punës dhe në kontratën kolektive në fuqi, në funksion të garantimit të ushtrimit efektiv të lirive sindikale.

Bazuar në nenin 13 të Kontratës Kolektive të Punës nr. 3641/1, datë 09.06.2023, “Ushtrimi i të drejtave sindikale në arsimin parauniversitar publik”, përcaktohet se: *13.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit tërheq vazhdimisht mendimin e sindikatave nënshkruese të kësaj kontrate kolektive në procesin e hartimit të akteve ligjore e nënligjore që lidhen me reformën në arsim, me marrëdhëniet e punës, pagat, shpërblimet, kushtet e punës etj. 13.2 Sindikatat kanë të drejtë të informohen dhe të konsultohen për çdo ndryshim të politikave që lidhen me marrëdhëniet e punës dhe procesin mësimor. 13.3 Për të garantuar të zgjedhurit në pozicionet drejtuese sindikale për kryerjen e detyrës së tyre, punëdhënësi nuk mund t’i largojë nga puna ose t’ua ndryshojë vendin e punës pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të kryesisë përkatëse sindikale. 13.4 Punëmarrësit kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet sindikale brenda dhe jashtë orarit të punës, pa penguar procesin mësimor. 13.5 Punëdhënësi nuk mund të ndërmarrë masa diskriminuese kundër punonjësve për shkak të pjesëmarrjes në veprimtaritë sindikale. 13.6 Sindikatat mund të organizojnë takime, trajnime dhe aktivitete informative në hapësirat e shkollës, duke respektuar rregullat e sigurisë dhe funksionimin normal të procesit mësimor. 13.7 Punëdhënësi në nivel institucioni arsimor vë në dispozicion të punëmarrësit një kopje të Kodit të Punës dhe një kopje të kontratës kolektive të punës. 13.8 Çdo mosmarrëveshje lidhur me ushtrimin e të drejtave sindikale zgjidhet në bashkëpunim midis sindikatave dhe punëdhënësit, sipas procedurave të parashikuara në këtë kontratë dhe në Kodin e Punës.*

Në të njëjtën linjë, neni 13 i Kontratës Kolektive nr. 3641/1, datë 09.06.2023, nuk krijon një trajtim përjashtues për sindikatat jonënshkruese, por përcakton kornizën dhe kushtet për ushtrimin e të

drejtave sindikale në arsimin parauniversitar publik. Dispozitat e këtij neni kanë karakter rregullues dhe garantues dhe duhet të interpretohen si të zbatueshme për çdo sindikatë që operon ligjërisht në sektorin arsimor, në përputhje me Kodin e Punës. Çdo interpretim që do t'i mohonte sindikatave jonëshkruese aspektet minimale të veprimtarisë sindikale vetëm për shkak të mosnënshkrimit të kontratës kolektive do të ishte në kundërshtim me tekstin, qëllimin dhe frymën e ligjit dhe të vetë kontratës kolektive.

Për më tepër, institucionet përgjegjëse për marrëdhëniet e punës dhe administrimin e arsimit duhet të sigurojnë një ambient ku aktiviteti sindikal mund të zhvillohet pa pengesa administrative, pa diskriminime të bazuara në statusin formal të sindikatave dhe në përputhje me standardet ligjore, përfshirë ato të përcaktuara në Kodin e Punës dhe në kontratat kolektive në fuqi. Kjo qasje garanton jo vetëm respektimin e të drejtave themelore të punonjësve për organizim dhe pjesëmarrje sindikale, por edhe funksionimin normal të institucioneve dhe procesit arsimor, duke krijuar një ekuilibër midis mbrojtjes së të drejtave të punonjësve dhe realizimit të detyrimeve institucionale.

Për rrjedhojë, çdo praktikë që do të pengonte ose kufizonte ushtrimin e këtyre të drejtave për shkak të mosnënshkrimit të kontratës kolektive do të ishte në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e ligjit, si dhe me parimet e trajtimit të barabartë, dhe rrezikon të vendosë sindikatat jonëshkruese në një pozicion të pafavorshëm, pavarësisht përfaqësimit të tyre të konsiderueshëm në radhët e punonjësve.

Rezultoi e provuar se, Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë e ka trajtuar palën ankuese në mënyrë më pak të favorshme në ushtrimin e lirisë sindikale, duke kufizuar hyrjen dhe veprimtarinë e saj në ambientet e institucionit, vetëm për shkak se SBASH nuk është organizatë sindikale nënshkruese e kontratës kolektive të punës me MA. Shkolla ka ndjekur interpretim e nenit 181, pika 7, të Kodit të Punës dhe udhëzimet e dhëna nga MA, duke e lidhur lejimin e ushtrimit të aktivitetit sindikal me statusin e nënshkrimit të kontratës kolektive, edhe pse një kriter i tillë nuk gjen mbështetje në kuadrin ligjor që garanton barazinë e organizatave sindikale. Në këtë mënyrë, shkolla ka aplikuar një standard të ndryshëm të trajtimit midis sindikatave nënshkruese dhe atyre jonëshkruese, në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, duke vendosur SBASH në kushte të pabarabarta.

Referuar Ligjit Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 6, pika 9 parashikon se: *sistemi arsimor parauniversitar funksionon mbi bazën e decentralizimit dhe autonomisë së institucioneve arsimore*. Ndërkohë, sipas nenit 54, të ligjit të sipërcituar, drejtori i institucionit arsimor publik ose privat ndër të tjerë është përgjegjës për: zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor; menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit. Përveç kësaj, drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe detyrat e mëposhtme: menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar.

Sipas nenit 42, pika 3, të Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar sipas urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit,

Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Drejtori ka përgjegjësinë për zbatimin në IA të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi”*. Ushtrimi i lirisë sindikale, sipas parashikimeve të Kodit të Punës, përfshi nenit 181, pika 7, nuk bën pjesë tek bashkëpunimet dhe veprimtaritë në kuptim të pikës 6, të nenit 42, të Rregullores, ku parashikohet: *“6.Drejtori krijon mundësi të bashkëpunimit të IA-së me institucione publike dhe private, brenda ose jashtë vendit, dhe me institucione arsimore analoge. Pas shqyrtimit të këtyre bashkëpunimeve në këshillin e mësuesve, drejtori i IA-së publike merr miratimin për to nga titullari i ZVA-së përkatëse. Në rastet kur organizatat jopublike apo persona të tjerë juridikë kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në ambientet e IA-së, merret miratimi paraprak i ministrisë.”*, për të cilat duhet të marrë miratimin nga ZVA-ja përkatëse ose miratimi paraprak i ministrisë.

Në referim të dispozitave të mësipërme ligjore është përcaktuar qartë autonomia e institucioneve arsimore dhe përgjegjësitë ligjore të drejtuesve të tyre, të cilat duhet të respektohen në çdo veprim të organizuar brenda institucionit. Institucionet arsimore gëzojnë autonomi në organizimin e veprimtarisë së tyre, ndërkohë që drejtuesit e tyre janë të detyruar të ushtrojnë kompetencat e përcaktuara ligjore në përputhje me këtë autonomi. Kjo përfshin menaxhimin e institucionit, të personelit dhe të burimeve financiare, si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve, duke garantuar gjithmonë respektimin e ligjit, të akteve nënligjore dhe të drejtave të të gjithë aktorëve brenda institucionit, përfshirë barazinë në ushtrimin e aktivitetit sindikata.

ZVAP Tiranë, prapësoi se nuk ka patur një praktikë të administruar në lidhje me rastet objekt shqyrtimi, por ZVAP si institucion që mbikëqyr dhe kontrollon institucionet arsimore, vlerëson se vendimmarrja e Drejtorit të Shkollës është një vendim i drejtë dhe se, organizatat që nuk kanë nënshkruar një kontratë kolektive me Ministrinë e Arsimit nuk mund të lejohen të ushtrojnë liritë sindikale në mjedisin e punës, pra në mjediset e institucionit arsimor. Gjithashtu, në raste të tjera të ngjashme me institucione të tjera arsimore, ku ZVAP Tiranë ka pranuar se ka patur dijeni, ka mbajtur të njëjtin qëndrim¹³.

Bazuar në VKM Nr. 99, datë 27.2.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencisë kombëtare të arsimit parauniversitar”* (ndryshuar me VKM nr. 129, datë 6.3.2024 dhe nr. 121, datë 27.2.2026), përcaktohet se, zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP-të) janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryejnë ndër të tjera këto detyra: *“a) Menaxhojnë, mbikëqyrin, vlerësojnë dhe kontrollojnë institucionet arsimore parauniversitare për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.”*

ZVAP Tiranë, nuk është autoriteti i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë ka vendimmarrjen për menaxhimin ose për të lejuar apo jo futjen e palës ankuese në shkollë, por si një institucion që

¹³ Shiko: Vendimi nr. 142 datë 03.06.2025 dhe Vendimi nr.8, datë 13.01.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

mbikëqyr dhe kontrollon institucionet arsimore, nuk ka vepruar dhe nuk ka marrë masa për të eliminuar trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm ndaj palës ankuese SBASH. Ky qëndrim i ZVAP Tiranë, dukshëm bazohet në udhëzimet dhe interpretimin që Ministria e Arsimit i bën nenit 181, pika 7, të Kodit të Punës. Edhe pse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, sjellja e ZVAP Tiranë përbën një formë udhëzim ndaj institucionit arsimor, i cili është një institucion i cili monitorohet dhe mbikëqyret nga ana e ZVAP Tiranë. Shkresat e MA me interpretimet dhe udhëzimet për zbatim nga ana e institucioneve të varësisë janë përcjellë pranë ZVAP Tiranë, në mënyrë që kjo e fundit të bëjë përcjelljen e tyre pranë institucioneve arsimore.

Ministria e Arsimit, ka udhëzuar në mënyrë të shprehur në shkresat adresuar ZVAP Tiranë, por edhe institucioneve të tjera të varësisë, se pala ankuese SBASH nuk mund të ushtrojë të liritë sindikale në mjedisin e punës, pra në shkollë, pasi nuk është një organizatë nënshkruese e kontratës kolektive të punës me MAS.

Në këto kushte, në referim të nenit 3, pika 2, të LMD, Komisioneri vlerëson se Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë, ka ushtruar një formë të diskriminimit të drejtpërdrejtë ndaj palës ankuese, pasi e ka trajtuar atë në mënyrë më pak të favorshme duke mos e lejuar të ushtrojë liritë sindikale në mjedisin e punës, në ambientin e institucionit arsimor, për shkak se *“nuk është organizatë sindikale e cila ka nënshkruar kontratë kolektive pune me MAS”*.

Direktivat e Bashkimit Evropian për mosdiskriminimin, nuk ofrojnë një përkufizim të “udhëzimit për të diskriminuar”, por përcaktojnë se “udhëzimi për diskriminim” përbën diskriminim¹⁴. Në mënyrë që të ketë vlerë në luftimin e praktikave diskriminuese “udhëzimi për të diskriminuar” nuk duhet të kufizohet vetëm në trajtimin e udhëzimeve që janë të detyrueshme në natyrë, por duhet të shtrihet për të kapur situata ku ka një preferencë të shprehur ose një inkurajim për t’i trajtuar individët në mënyrë më pak të favorshme për shkak në një prej shkaqeve të mbrojtura.¹⁵

“Udhëzimi për të diskriminuar” si formë diskriminimi është trajtuar nga GJEDNJ. Në çështjen *Bączkoëski dhe të tjerët kundër Polonisë*, Kryetari i Bashkisë së Varshavës bëri deklaratë publike me natyrë homofobike, ku deklaronte se do të refuzonte lejimin e një marshimi për rritjen e ndërgjegjësimin për diskriminimin për shkak të orientimit seksual. Kur vendimi ishte përpara organit administrativ përkatës, leja u refuzua për arsye të tjera, të tilla si nevoja për parandalimin e përplasjeve ndërmjet demonstruesve. Në këtë rast, GJEDNJ konsideron se në vlerësimin e çështjes nuk mund të mos pranojë mendimet e forta personale të shprehura publikisht nga Kryetari i Bashkisë për çështje që lidhen drejtpërdrejtë me vendimet në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit. Ajo vëren se vendimet në fjalë u morën nga autoritetet komunale që vepronin në emër të kryetarit pasi ai i bëri të njohur opinionet e tij në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit dhe “propagandës për

¹⁴ Neni 2(4), Direktiva për Barazinë në Punësim; Neni 4(1), Direktiva e trajtimit të Barabartë Gjinor në lidhje me aksesin dhe ofrimin e Mallrave dhe Shërbimeve; Neni 2(2) (b), Direktiva për Barazinë Gjinore (e rishikuar); Neni 2(4), Direktiva për Barazinë Raciale.

¹⁵ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf

homoseksualitetin”. Sipas GJEDNJ, mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme që mendimet e Kryetarit të Bashkisë së Varshavës mund të kenë ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe si pasojë të shkëlqen në mënyrë diskriminuese të drejtën e aplikantëve për lirinë e mbledhjes dhe kjo përbënte një shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 11, për shkak të orientimit seksual.

Bazuar në nenin 33, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet: “3. *Organi publik që zhvillon procedurën administrative, me kërkesë apo kryesisht, përfshin si palë në procedurë çdo person tjetër, të përcaktuar ose lehtësisht të përcaktueshëm, të ndryshëm nga ato të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, të cilin, rezultati i procedurës administrative mund ta cenojë në të drejtat apo interesat e tij të ligjshëm.*”, Komisioneri përfshiu në procedurën administrative edhe Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Ministrinë e Arsimit.

Pavarësisht se ankesa formalisht është paraqitur vetëm ndaj Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, Tiranë, në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, kompetenca e Komisionerit i lejon atij që, mbi bazën e gjendjes faktike, provave të administruara dhe veprimeve konkrete të subjekteve të përfshira, të konstatojë se diskriminimi ndaj palës ankuese ka ardhur edhe nga institucione të tjera publike. Në këtë rast, të dhënat e administruara tregojnë se jo vetëm shkolla, por edhe ZVAP Tiranë dhe Ministria e Arsimit, përmes qëndrimeve të tyre zyrtare, kanë kontribuar në krijimin dhe zbatimin e një praktike të diferencuar ndaj palës ankuese. Për rrjedhojë, kompetenca e Komisionerit shtrihet mbi çdo subjekt publik që ka marrë pjesë në sjelljen diskriminuese, pavarësisht se kush është institucioni i referuar në ankesën fillestare.

Në këto kushte, në referim të nenit 3, pika 15, të LMD, Komisioneri vlerëson ZVAP Tiranë dhe MA, e kanë diskriminuar palën ankuese SBASH në formën e udhëzimit për të diskriminuar, për shkak se “*nuk është organizatë sindikale e cila ka nënshkruar kontratë kolektive pune me MAS*”.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, ZVAP Tiranë dhe MA, e kanë diskriminuar palën ankuese SBASH në ushtrimin e lirisë sindikale, duke e vendosur atë në kushte më pak të favorshme për shkak se SBASH “*nuk është organizatë sindikale e cila ka nënshkruar kontratë kolektive pune me MAS*”. Për rrjedhojë, Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, ZVAP Tiranë dhe MA, kanë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”.

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në

diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankueses konsiston në moslejimin për të ushtruar liritë sindikale në mjedisin e punës. Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, duhet të jetë lejimi i palës ankuese që të ushtrojë liritë sindikale në mjedisin e punës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e *diskriminimit të drejtpërdrejtë* të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shqiptar (SBASH), për shkakun e pretenduar të diskriminimit¹⁶, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Lushnje”, Tiranë.
2. Konstatimin e *diskriminimit në formën e udhëzimit për të diskriminuar* të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shqiptar (SBASH), për shkakun e pretenduar të diskriminimit, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
3. Konstatimin e *diskriminimit në formën e udhëzimit për të diskriminuar*, të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shqiptar (SBASH), për shkakun e pretenduar të diskriminimit, nga ana e Ministrisë së Arsimit.
4. Në referim të pikës 1, 2 dhe 3 të Vendimit, Ministria e Arsimit, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, Tiranë, të marrin masa për:
 - Të ndaluar në mënyrë të menjëhershme çdo sjellje që ndalon dhe pengon Sindikatën e Bashkuar të Arsimit Shqiptar (SBASH) për të ushtruar liritë sindikale të parashikuara nga Kodi i Punës, në mjedisin e punës.
 - Garantimin e ushtrimit të lirive sindikale të parashikuara nga Kodi i Punës, nga ana e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shqiptar (SBASH).
5. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”, Tiranë, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

¹⁶Shkaku i diskriminimit “*organizatë sindikale që nuk ka nënshkruar një kontratë kolektive pune me Ministrinë e Arsimit*”.

6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

Shkaku: *“organizatë sindikale që nuk ka nënshkruar një kontratë kolektive pune me Ministrinë e Arsimit”.*

Fusha: Punësim

Lloji i vendimit: Diskriminim i drejtpërdrejt dhe Udhëzim për diskriminim